S T A T U T I

I

Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

" SMART MARKET" Sh.p.k.

Ne Tirane,sot me date 02/09/2020,themeluesit deklarojne se Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin **"SMART MARKET"** Sh.p.k.,e themeluar prej ortakeve, do ta zhvilloje veprimtarine e saj sipas dispozitave te poshteshenuara te ketij Statuti ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",te ndryshuar me ligjin nr.129/2014.

KREU I

Dispozita te pergjitheshme

Neni 1

FORMA JURIDIKE E SHOQERISE

Shoqeria **"SMART MARKET"** sh.p.k eshte themeluar nga tre ortaket **GREGORI PUSHI**, atesia Robert ,lindur me 27.09.2000,pajisur me kart identiteti nr 033762824, me nr personal .K00927065B,banues ne Berat.

MAKSIM MUSTA, atesia Nuri, lindur me 26.07.1984,identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.025167018, numer personal I40726002S,banues ne rruga "Rexhep Torja" 129 Tirane.

GENCI ZERELLI, atesia Eles, lindur me 11.05.1985, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr 033234440, numer personal I50511074D,banues ne rrugen e "kokonozeve" Tirane dhe ka formen juridike te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e Shoqerise eshte **per afat kohor te pacaktuar.**

Neni 3

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria " **SMART MARKET** " sh.p.k. fiton personalitetin juridik diten qe regjistrohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Shoqerive Tregtare.

Viti i pare financiar i Shoqerise fillon diten qe do leshohet leja perkatese nga organet tatimore dhe do te mbyllet me daten 31 Dhjetor te te njejtit vit, ndersa vitet e tjera financiare do te fillojne me daten 1 janar dhe do te perfundojne me daten 31 dhjetor te te njejtit vit.

Scanned with CamScanner

Rregullimi juridik i veprimtarise se shoqerise do te behet sipas dispozitave te Aktit te Themelimit te Shoqerise,te ketij Statuti dhe legjislacionit shqiptar ne pergjithesi.

Neni 4
SELIA E SHOQERISE

Selia eshte : Rruga "Aleksander Moisiu"zona kadastrale 8120 nr pasurie 5/359-N6 Tirane. Shoqeria mund te krijoje dege, perfaqesi ose agjensi ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj.

Neni 5
VULA E SHOQERISE

Shoqeria ka vulen e saj ne forme te rrubullaket ose katrore dhe me mbishkrimin **"SMART MARKET "**.

Neni 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise te Shoqerise " **SMART MARKET** ,, Sh.p.k do te jete :

Import-eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave dhe artikuj te ndryshem industriale, ushqimore, blegtorale dhe bujqesore, pijeve freskuese dhe alkolike, duhan, cigare. Hapja e marketeve-supermarketeve.

Kembim valutor.Veprimtari e agjentit per transferte parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. Veprimtari e agjentit komisioner.

Hapjen e agjensive te udhetimit, turistike dhe reklamash. Hapjen e agjensive per shitjen e biletave ajrore, detare dhe tokesore. Transport mallrash dhe udhetaresh per vete dhe te trete brenda e jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Hapjen e dyqaneve per tregtimin e bizhuterive te te gjitha llojeve prej floriri, argjendi, sermi, diamanti, etj.

Hapjen e qendrave dhe kompleksveve sportive per argetimin dhe çlodhjen e njerezve, salla lojrash per femije dhe te rritur, salla per ushtrimin e forces per femije e te rritur. Hapjen e qendrave estetike, masazheve dhe kozmetike.

Sherbim ne fushen e ushqimit social, bar-restorant, piceri, hoteleri, sherbime ne fushen e turizmit. Zhvillim te aktivitetit tregtar ne dyqane te te gjitha llojeve, lokale, markete dhe hipermarkete. Eksport-import sipas legjislacionit shqiptar.

Kultivimi i produkteve bujqesore dhe frutikultures si dhe tregtimin me shumice e pakice i produkteve te tyre; Cdo veprimtari tjeter qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Ndertim, menaxhim dhe shitje dyqanesh per shitje te mallrave me shumice e pakice per llogari te vete apo te treteve;blerje,rifurnizim te mallrave ushqimore te pergjitheshme ne bashkepunim me shoqeri dhe entitete te tjera, si dhe import-eksport te mallrave te ndryshme qe do te jene objekt i aktivitetit tregtare.

Menaxhimi i qendrave tregtare, bareve dhe restoranteve. Importi - eksporti, shitja me shumice dhe pakice e produkteve tekstile, veshje te te gjitha llojeve.

Tregtimi i artikujve te ndryshem. Importi - eksporti shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te para per industrine, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, pajisje zyrash kancelari, pjese kembimi, auto dhe makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike etj.

KREU II
Kapitali Themeltar

Scanned with CamScanner

Neni 7
KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA

Kapitali themeltar i shoqerise " **SMART MARKET** " Sh.p.k. perbehet vetem nga kontributet ne para ne shumen shumen 100.000 (njeqindmije) leke.

1. Ortaku themelues z. **GREGORI PUSHI**: zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 33333.33 (tridhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre leke) leke që përben 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise;
2. Ortaku themelues z. **MAKSIM MUSTA** zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 33333.33 (tridhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre leke) leke që përben 33.33%
3. Ortaku themelues z. **GENCI ZERELLI** zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 33333.33 (tridhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre leke) leke që përben 33.33%.

Ortaket, nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tij. Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre.

Neni 8
Zmadhimi i kapitalit themeltar

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Zmadhimi i kapitalit themeltar nuk perfaqeson kontributet ne sherbime.

Ne cdo rast, zmadhimi i kapitalit themeltar shoqerohet edhe me ndryshimet perkatese ne QKB, ku percaktohet shprehimisht pjesmarrja e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te zmadhuar si dhe kuota e re.

Neni 9
Zvoglimi i kapitalit themeltar

Zvoglimi i kapitalit themeltar behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Zvoglimi i kapitalit themeltar e prek ortakun ne ate mase, sa jane pjeset e kapitalit qe ai perfaqson.

Kur merret vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar nen limitin e parashikuar ne Kodin Tregtar per Sh.p.k.- te, i cili motivohet nga humbjet e rezultuara, atehere ky vendim do te shoqerohet me keto veprime :

1. Ndryshimi i tipit te shoqerise;
2. Ndryshimi i Statutit;
3. Publikimi dhe njoftimi i te treteve me te cilet shoqeria ka mardhenie kontraktuale si dhe i kreditoreve.

Kur miratohet nje projekt vendim per zvoglimin e kapitalit themeltar, qe nuk motivohet nga humbjet, kreditoret, kredia e te cileve eshte dhene para dates se publikimit te ndryshimeve perkatese ne Statut, mund ta kundershtojne zvoglimin e kapitalit brenda 1 (nje) muaji nga kjo date ne rruge gjyqsore.

Neni 10
Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar

Pjeset nominative te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve, ne rruge trashegimie tek paraardhesit dhe pasardhesit si dhe tek te tretet.

Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar behet me miratimin e oratakut te vetem te shoqerise.

Scanned with CamScanner

Ne te gjitha rastet e transferimit, emimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar do te caktohet sipas vleres aktuale te bilancit te shoqerise ne momentin qe do te behet transferimi.

KREU III
Administrimi i Shoqerise
Neni 11
Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per percaktimin e politikave tregetare te shoqerise,per ndryshimet e statutit, emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,si dhe te gjithe te drejtat e detyrimet e tjera te parashikuara ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Te drejtat dhe detyrimet e Asemblese se Pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem , regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti ,por pa u kufizuar ne to, vendimet per : 1)Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; 2)Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; 3)Investime ; 4) Vendime per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paraegjistruara ne regjistrine evendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

Neni 12
ADMINISTRATORI DHE MENYRA E CAKTIMIT

Administratoret e Shoqerise "**SMART MARKET**" Sh.p.k. jane:
Maksim Musta, per afatin kohor 5 (pese) vjecar.
Genci Zerelli, per afatin kohor 5 (pese) vjecar.

Administratoret caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme mund te caktoje nje ose me shume administratore, te cilet mund te jene persona vendas ose te huaj.

Neni 13
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i Shoqerise " **SMART MARKET** " Sh.p.k. ka te gjitha kompetencat qe ligji ka caktuar per administratoret, pa asnje kufizim.

Lejohet qe administratori te delegoje tek personat e trete nje apo disa nga kompetencat qe kane te bejne me ushtrimin e funksioneve te vecanta, si drejtimi teknik, drejtimi financiar, etj.

Neni 14
NDRYSHIMET E STATUTIT

Ndryshimet e Statutit behen me vendimin e Asamblese se Pergjithshme dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 15
EMERIMI DHE SHKARKIMI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR

Scanned with CamScanner

Emerimi i eksperteve kontabel te autorizuar eshte i detyrueshem kur ne mbyllje te vitit financiar tejkalohen dy nga keta tre tregues :

1) Totali i bilancit : 40.000.000 leke.
2) Te ardhurat pa taksat : 30.000.000 leke.
3) Numri mesatar i te punesuarve : 30 vete.

Ekspertet kontabel i autorizuar emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme .Ne rast gabimi ose pengimi, eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Jane te pavlefshme : shqyrtimet e bera pa ekspert kontabel te autorizuar kur kjo eshte e detyrueshme nga ligji,si dhe raportet e eksperteve kontabel, qe jane emeruar ne kundershtim me rregullat e parashikuara nga Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Neni 16
SHNDERRIMI I SHOQERISE

Shnderrimi i shoqerise " **SMART MARKET** " Sh.p.k. ne nje shoqeri aksionare behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme me nje shumice prej tre te katertave dhe sipas procedures percaktuar ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Para marrjes se vendimit per shnderrimin ne shoqeri anonime ,njoftohet per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit .

KREU IV
Fondet e Shoqerise, Fitimi dhe Dividentet

Neni 17
REZERVA E DOMOSDOSHME

Shoqeria " **SMART MARKET** " Sh.p.k.eshte e detyruar qe te krijoje fondin e quajtur " Rezerva e domosdoshme ", duke lene menjane 1/20 e fitimit te rezervuar gjate vitit financiar , pasi te jene zbrituar humbjet e vitit te meparshem.

Ky rregull nuk vlen kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Neni 18
SHPERNDARJA E FITIMIT

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, pasi zbriten shumat e lena menjane per rezerven dhe pasi zbriten ose shtohen respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e mepareshme.

Fitimet neto,sipas kuotave , do te ndahen ne muajin prill te cdo viti pasardhes.

Asamblese se Pergjithshme mund te marre vendim qe te shperndaje edhe shumat e lena menjane per rezerven qe ka ne dispozicion, por ne kete rast vendimi duhet te tregoje shprehimisht llojin e rezerves ku merren shumat.shperndarja e fitimit do te jete si me posht :

50% e vleres neto do shpendahet 3 ortakeve perkatesisht nga 33.33 %. dhe 50% e vleres tjeter do kaloj per rritje kapitali.

Neni 19
PERCAKTIMI I DIVIDENTEVE

Scanned with CamScanner

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te shumes qe do te shperndahet, Asamblese se Pergjithshme percakton pjesen qe i takon ortakeve ne forme dividenti (Ndarja e fitimit ne raport me kuoten qe zoterojn ortaket).

Shoqeria ka te drejte te jape edhe paradhenie, vlera e te cilave ka rrjedhur nga vitet financiare te mbyllura ose ne vazhdim, vlera keto te derdhura para mbylljes se vitit financiar, me kusht qe te vepro-het ne konformitet me Ligjin ne fuqi.

KREU V
Pavlefshmerite, Prishjet dhe Likuidimi i Shoqerise
Neni 20
RASTET E PAVLEFSHMERIVE

Pavlefshmeria e shoqerise " **SMART MARKET** " Sh.p.k. dhe pavlefshmeria e akteve perkatese te saj (Akt Themelimi, Statut, Vendime Asambleje, Raporte te ekspertit kontabel te autorizuar, te veprimeve te administratoreve, etj.) mund te rezultojne vetem nga shkeljet e dispozitave urdheruese apo ndaluese te Ligjit "Per tregataret dhe Shoqerite Tregtare" ose te legjislacionit ne fuqi per kontratat dhe veprimet juridike, te parashikuara ne Kodin Civil.

Pavlefshmeria e shoqerise " **SMART MARKET**" Sh.p.k. mund te rezultoje edhe nga paaftesia e ortakeve.

Neni 21
PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise " **SMART MARKET** " Sh.p.k. shpallet nga Asambleja e Pergjithshme ne rastet e poshteshenuara:

1. Me perfundimin e afatit te parashikuar ne Kontraten e Themelimit dhe ne Statut,neqoftese Asambleja e Pergjithshme nuk merr vendim per zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise.
2. Me humbjen e 1/2 se kapitalit themeltar, kur ky i fundit bie ne limitin e parashikuar per sh.p.k.-te ne Kodin Tregtar, rast per te cilin zbatohet kjo procedure:
3. Me fillimin e procedures se falimentimit sipas kerkesave te Ligjit.

Neni 22
LIKUIDIMI

Ne te gjitha rastet, kur me vendim te QKR shpallet pavlefshmeria absolute apo relative e shoqerise, si dhe ne rastet kur asambleja merr vendim per prishjen e saj (raste te parashikuara ne Statut), fillon procesi i likuidimit te shoqerise, proces i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin Tregtar Shqiptar.

ORTAKET

/Gregori Rustri/

/Maksim Musta/

/Genc Zekllì/

Scanned with CamScanner